

RAPORTI VJETOR 2021

Përgatitur për:

Mbledhjen e XIV-të të Kuvendit
të STIKK

8 Shkurt, 2022

Anëtarët e Artë:

appdec® 




PËRMBAJTJA

INFOGRAFIKA	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
Mbledhjet e Bordit të STIKK	5
Publikimet gjatë vitit	5
Informata për anëtarët	6
Prezenca në media	6
Stafi i STIKK	7
Trakimet, konferencat, punëtoritë dhe vizita	7
ANËTARËT E STIKK	9
AKTIVITETET E STIKK PËRGJATË VITIT 2021	10
Objektivi 1	12
Objektivi 2	17
Objektivi 3	18
TË HYRAT DHE SHPENZIMET E STIKK	20
KUVENDI I XIII-TË I STIKK	21

INFOGRAFIKA

TE HYRAT
NE VITE



B2B TAKIME: 7 KONFERENCA/PANAIRE: 14
PUBLIKIME: 4 GRUPE PUNUESE: 3

ANETARE TE RI: 9

SILVER 4

BRONZE 3

START-UP 1

BASHKEPUNUES 1

60+
TAKIME TE
REALIZUARA



4
Interviews



132 Poste
1165 Likes



26 Poste
227 Likes



47 Poste
454 Likes



3
Interviews

89 Poste
162,121 Reach

16 Poste
12,536 Reach

33 Poste
16,674 Reach

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2021, sikurse viti paraprak, kaloi me shumë të panjohura dhe përgjatë tërë vitit u ndjenë pasojat e shkaktuara nga pandemia **COVID-19**. Përkundër këtyre peripetive, **STIKK** ka arritur të implementojë planin e punës për vitin 2021 duke arritur rezultate modeste në përputhshmëri me objektivat e përcaktuara gjatë definimit të planit të punës.



OBJEKTIVI 1: Krijimi i një mjedisi të favorshëm legjislativ dhe rritja e ndikimit në komunitet (faktorizimi).



OBJEKTIVI 2: Fuqizimi i rrjetëzimit dhe rritja e anëtarëve - përmirësimi i shërbimeve për anëtarë.



OBJEKTIVI 3: Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut.

Nën objektivin e parë të planit të punës për vitin 2021 janë ndërmarrë hapa dhe janë organizu një seri takimesh dhe aktivitete të cilat kanë për qëllim hartimin e legjislacionit të favorshëm për zhvillimin e sektorit të TIK si dhe të fuqizojnë pozicionimin e **STIKK**. Ndër kontributet aktive nën objektivin e parë përfshihen pjesëmarrjet në grupet e ndryshme punuesi si për **Agjenda Digjitale 2020-2030, Strategjia Kombetare per Zhvillim 2030, Strategjia per Digjitalizim te Arsimit**, etj.

Nën objektivin e dytë caku kryesor ishte zgjerimi i rrjetit të anëtarëve të **STIKK** si dhe ofrimi i shërbimeve kualitative nga shoqata. Ndër aktivitetet kryesore që kontribojnë në këtë objektiv përfshihen: themelimi kllasterit **"Women in Tech"** përbrenda ombrellës së **STIKK**, dhe inicimi i themelimit të kllasterit **"eCommerce"**. Tjetër aktivitet shumë i rëndësishëm nën këtë objektiv ishte edhe organizimi i edicionit të 10 të festivalit të teknologjisë KosICT më 22 dhe 23 Tetor në ITP Prizren.

Përfundimisht, **nën objektivin e tretë** aktivitetet e ndërmarra kishin për qëllim krijimin e kushteve të qëndrueshme për veprimtarinë e **STIKK**, si nga aspekti funksional poashtu edhe financiar. Ky objektiv u mbështet nga aktivitete draftimi dhe aprovimi i projekteve dhe thirrjeve të ndryshme, ngritja e kapaciteteve të stafit të **STIKK** përmes trajnimeve profesionale dhe zgjerimi i anëtarësisë.

MBLEDHJET E BORDIT TË STIKK

Bordi i **STIKK**, si organi kryesor i vendimmarrjes rreth planeve, aktiviteteve dhe fokusit të **STIKK**, përgjatë vitit 2021 ka mbajtur gjithsej **10** mbledhje ku prej tyre **5** ishin të rregullta ndërsa **5** të jashtëzakonshme. Mbledhjet e Bordit ishin:

- **Planifikimi i Kuvendit të anëtarëve (XIII)- 20.01.2021 - Jashtëzakonshme**
- **Mbledhja e 71 e Bordit të STIKK- 02.04.2021 - Rregullt**
- **Takim rreth lokacionit të KosICT (10th)- 15.06.2021 - Jashtëzakonshme**
- **Mbledhja e 72 e Bordit të STIKK- 06.07.2021 - Rregullt**
- **Mbledhja e 73 e Bordit të STIKK- 14.09.2021 - Rregullt**
- **Takim rreth organizimit të KosICT (10th)- 14.10.2021 - Jashtëzakonshme**
- **Mbledhja e 74 e Bordit të STIKK- 05.11.2021 - Rregullt**
- **Mbledhja e 75 e Bordit të STIKK- 10.12.2021 - Rregullt**
- **Takim rreth planit të punës 2022- 16.12.2021 - Jashtëzakonshme**
- **Takim rreth planit të punës 2022 (pt.2)- 22.12.2021 - Jashtëzakonshme**

PUBLIKIMET GJATË VITIT

Përgjatë vitit 2021, STIKK ishte mjaft aktiv në disa hulumtime me partnerë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar. Gjatë këtij viti u publikuan 2 raporte të detajuara dhe **2** storje të suksesit të lidhura me industrinë tonë. Publikimet janë:

- **IT Barometer 2020 - 05.2021:**

(<https://stikk.org/wp-content/uploads/2021/06/IT-Barometri-2020.pdf>)

- **Women in ICT - 06.2021:**

(<https://stikk.org/wp-content/uploads/2021/06/Women-in-ICT-Report-2021.pdf>)

- **Storje sukcesi - Kutia:**

(<https://stikk.org/wp-content/uploads/2021/11/Kutia-ALB.pdf>)

- **Storje sukcesi - Frakton:**

(<https://stikk.org/wp-content/uploads/2021/11/Frakton-ENG.pdf>)

INFORMATA PËR ANËTARËT

Viti 2021 përsëri u karakterizua me takime, organizime e evente të ndryshme kryesisht virtuale. Përgjatë vitit, **STIKK** ishte mjaft aktiv me organizimin dhe co-organizimin e eventeve dhe B2B-ve të ndryshme e kryesisht ndërkombëtare, por edhe në shpërndarjen e informatave të rëndësishme për komunitetin tonë e të cilat burimin e kishin nga partnerët tanë bashkëpunues si USAID, KIESA, Access, ICT for Kosovo's growth, etj. Përmes platformës MailChimp, anëtarët e **STIKK** gjatë 2021 pranuan:

FTESA PËR B2B TAKIME = 18

NJOFTIME = 16

PYETËSOR/HULUMTIME = 7

INICIATIVA = 15

SESIONE INFORMUESE = 14

FTESA DHE INFO TË NDRYSHME = 19

PREZENCA NË MEDIA

Faktorizimi i **STIKK** dhe ngritja e çështjeve të ndryshme në benefit të komunitetit të TIK-ut dhe anëtarësisë së **STIKK** ka qene edhe njëri ndër objektivat kryesorë për vitin 2021. Lidhur me të, e poashtu edhe me qëllimin e njoftimit të komunitetit me lajmet, thirrjet dhe mundësit e reja, **STIKK** kishte prezence të shtuar në mediat tradicionale (TV) këtë vit, pa e anashkaluar edhe efektin e rrjeteve sociale. Kjo prezencë përfshin:

				
	4 Interviews	132 Poste 1165 Likes	26 Poste 227 Likes	47 Poste 454 Likes
	3 Interviews	89 Poste 162,121 Reach	16 Poste 12,536 Reach	33 Poste 16,674 Reach

STAFI I STIKK



Gjatë periudhës janar - dhjetor 2021, në **STIKK** ka patur disa ndryshime dhe shtesa në stafin e zyrës ekzekutive. Fillimisht në muajin shkurt nga ekipi u largua Kaltrina Beha, asistente e financave. Më pas në muajin tetor, pak para fillimit të edicionit të 10 të festivalit të teknologjisë KosICT, përmes projektit **Route WB6** dhe në form të intershipit ekipit iu bashkangjitën z. Aldo Baxhaku dhe znj. Eresti Mullahu nga Elbasani në rol të asistent koordinator të projekteve. Të dy ishin pjesë e ekipit të **STIKK** deri në fund të muajit nëntor kur znj. Mullahu u kthye në Shqipëri ndërsa z. Baxhaku iu ofrua mundësia t'i bashkohet ekipit të **STIKK** si anëtar i plotë. Viti 2021 u përmbyll me ndryshimin e fundit në përbërjen e stafit të **STIKK**, ku pas përfundimit të KosICT në fund të muajit tetor, nga ekipi u largua edhe z. Labinot Kelmendi, asistent menaxher i projekteve.

TAKIMET, KONFERENCAT, PUNËTORITË & VIZITAT

Kalendari i anëtarëve të ekipit të **STIKK** përgjatë vitit 2021 ishte mjaft i ngjeshur. Takimet, konferencat, punëtoritë e vizitat e ndryshme të tyre ishin:

- | | |
|--|--|
| 06 Janar - Takim me ConCom | 18 Shkurt - Takim me US Embassy |
| 14 Janar - EU project partner discussion | 19 Shkurt - Takim me GIZ CETEP |
| 15 Janar - Takim me GIZ CETEP | 22 Shkurt - ICT for KS growth Steering C. |
| 18 Janar - TourInn project meeting | 26 Shkurt - Femmepreneurs Event |
| 21 Janar - USAIDEDGE partners meeting | 02 Mars - Qatar Matchmaking Event |
| 25 Janar - Takim me GIZ CETEP | 03 Mars - Takim me UNDP |
| 26 Janar - Takim me USAID Kosovo Compete | 04 Mars - Collab. Workshop me Medical Valley (DE) |
| 27 Janar - Takim me Klubin e Prodhuesve | 08 Mars - Takim me KCSF |
| 27 Janar - Collab. Workshop me Josephs (DE) | 10 Mars - USAID EDGE - Online Event |
| 28 Janar - Italy Meets Digital Kosovo Event | 10 Mars - Agile IT project management workshop |
| 28 Janar - Diskutim me P.Politike (Telegrafi) | 11 Mars - Takim me MTI |
| 01 Shkurt - Takim me kandidat për Kryeministër të RKS | 12 Mars - EYE Network Meeting |
| 11 Shkurt - Takim me The Palladium Group | 17 Mars - EYE Consortium Meeting |
| 12 Shkurt - Takim me shoqatat e biznesit | |

24 Mars - Takim me USAID Kosovo Compete
29 Mars - Takim me UNICEF
07 Prill - USAIDEDGE partners meeting
10 Prill - IPA CBC (KS & NMK) partners meet.
20 Prill - Takime B2B në Ferizaj
22 Prill - Prishtina Match4ICT Event
22 Prill - Donor Coordination meeting
23 Prill - Takim në mes të ENN Kosovo & Albania
26 Prill - Takim me MASHT
27 Prill - Nënshkrimi i kontratës me ABCJ
28 Prill - Takim me ABSA (ALB)
29 Prill - Takim i kllasterit Women in Tech
06 Maj - Takim me KIESA
07 Maj - EYE Consortium meeting
07 Maj - Takim me World Bank
11 Maj - Vizite tek Tenton
12 Maj - USAIDEDGE partners meeting
17 Maj - Mbledhje e Bordit të ICK
18 Maj - Takim me SheEra
19 Maj - Takim me Smart4All EU project
21 Maj - Takim me Rrjetin e Grave
24 Maj - IPA CBC (KS & ALB) partners meet.
25 Maj - Vizitë në K. Kukës (ALB) për IPA CBC
25 Maj - Vizitë në K. Istog për IPA CBC
28 Maj - Takim me CETEP GIZ
31 Maj - Takim me HELP!
02 Qershor - Takim me Germin
02 Qershor - Takim me MZHE
03 Qershor - Takim me Verpura
09 Qershor - Vizitë tek evroTarget
09 Qershor - Takim me Flossk
17 Qershor - Takime B2B në Gjakovë
17 Qershor - Takim me ACCESS & ADA
18 Qershor - Takim me m. Rozeta Hajdari
21 Qershor - Takim me LuxDev
23 Qershor - Takim me zyrën e Kryeministrit
23 Qershor - Takim i kllasterit "WiT"
28 Qershor - Takim me Deloitte Future Stars
29 Qershor - VET Summit Event
30 Qershor - Takim me ACCESS
05 Korrik - Takim me ICT Cortex MNG
07 Korrik - Info session - Programi i granteve të përputhshme
07 Korrik - Vizitë në K. Has (ALB) për IPA CBC
13 Korrik - Takim me MZHE
16 Korrik - Qev. Korporative Workshop
26 Korrik - Takimi me m. Hekuran Murati
05 Gusht - GIZ Workshop - Entrepreneur.
05 Gusht - Takim me ABCJ
11 Gusht - Takim me Route WB6
11 Gusht - Takim me Roy Rezek (ISR)
14 Gusht - EU Support to Start-Ups meet.
20 Gusht - Takim me KIESA
24 Gusht - Takim me ITP Prizren
25 Gusht - Takim me Përparim Rama
31 Gusht - Takim me MINT
07 Shtator - ICT for KS growth Steering C.
09 Shtator - Dhënia vullnetare e gjakut
13 Shtator - Takim me Amb. Hungareze
15 Shtator - Takim për Digital Agenda
16 Shtator - Takim me Accedia (BG)
17 Shtator - Women in STEM meeting
24 Shtator - Takim me Universum
27 Shtator - Takim me d. Doarsa Kica
29 Shtator - Takim me FIEK
05 Tetor - Takim me W3-Lab
05 Tetor - Company Mission në Vienë
11 Tetor - Takim me ODK
22 & 23 Tetor - KosICT 10th Edition
01 Nëntor - Takim me ARKEP
02 Nëntor - Takim me MASHT
24 Nëntor - B2B takime me k. Hungareze
24 Nëntor - Takim me MPJ
25 Nëntor - Vizitë tek Banaku
02 Dhjetor - Takim me IREX & Crimson C.
22 Dhjetor - Deloitte SheXo Club Event

ANËTARËT E STIKK

Viti 2021 solli një rritje të numrit të anëtarëve në **STIKK**. Gjatë këtij viti shoqatës iu bashkangjitën 9 anëtarë të ri, prej tyre:

INTES: Silver

TENTON: Silver

INCODEKS: Silver

W3 LAB: Silver

BANAKU: Bronze

NERDY CREATIVE: Bronze

PROTECH: Bronze

MOUNTER: Start-Up

**NEW GEN
NETWORK**

INSTITUTE: Bashkpunues

Në anën tjetër nga anëtarësia në **STIKK** gjatë 2021 kanë hequr dorë **2** kompani, *Sonnecto* dhe *Velez*.

Vitin **2021**, STIKK e pëmbylli me **60** anëtarë aktiv në shoqatë e prej tyre: **47** kompani anëtare, **12** anëtarë bashkpunues, **1** anëtar individual.

GOLD MEMBERS



SILVER MEMBERS



FRAKTION



TENTON



AKTIVITETET E STIKK

Përgjatë vitit 2021, ekipi i **STIKK** ishte mjaft aktiv me aktivitete, takime e iniciativa të ndryshe përmes të cilave u munduam t'i përmbahemi dhe përmbushim objektivat e përcaktuara. Në vazhdim mund t'i gjeni detajet e ndara në objektivat përkatës.

OBJEKTIVI 1: KRIJIMI I NJË MJEDISI TË FAVORSHËM LEGJISLATIV DHE RRITJA E NDIKIMIT NË KOMUNITET (FAKTORIZIMI)

Në përpjekje për të përmbushur qëllimet e objektivit të parë, anëtarët e ekipit të **STIKK** përgjatë vitit 2021 ishin pjesë e disa grupeve punuese, ku bashkë me ndihmën e anëtarëve të shoqatës ofruan inputet dhe kontributin e tyre në çështje dhe iniciativa të ndryshme në të mirë të sektorit e shoqërisë sonë dhe me qëllimin e shtuar të promovimit të veprimtarisë së anëtarëve të **STIKK** para faktorëve relevant. Përveç takimeve të shumta me akter të ndryshëm si ministri, institucione shtetërore, donator, qeverisje lokale, palë të ndryshme të interesit, bashkëpunorë potencial, etj, të evidentuara edhe paraprakisht në këtë raport, nën këtë objektiv poashtu përfshihen edhe kontributet në:

- Grupi punues "**Kosovo Digital Agenda 2030**" i udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik me pjesëmarrje të konsulentëve ndërkombëtarë e vendor lidhur me draftimin e strategjisë për digjitalizim. Përgjatë 2021, janë mbajtur **3** takime të grupit punues. **Përfaqësues:** Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive.
- Grupi punues "**Kosovo Smart Specialization Strategy**" i udhëhequr nga zyra e Kryeministrit të Kosovës nën përkrahjen e Bashkimit European lidhur me përpilimin e strategjisë nacionale për specializim të mençur. Përgjatë vitit 2021 janë mbajtur 2 takime të grupit punues dhe është realizuar "mappin" i disa industrive në vend për t'u analizuar gjatë takimeve në 2022. **Përfaqësues:** Dominik Deda, Menaxher i Projekteve.
- Pjesë e misionit diplomatik dhe biznesor "**Ljubljana Match4ICT**" i organizuar nga projekti ICT for Kosovo's Growth në bashkpunim me MZHE. Vizita u realizua nga 4 deri 8 tetor. Pjesë e delagacionit ishin përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe 6 kompani të TIK-ut. **Përfaqësues:** Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive.

- Pjesë e misionit diplomatik dhe biznesor "**Dubai EXPO 2020**" i organizuar nga KIESA dhe USAID Kosovo Compete Activity. Dubai EXPO ishte njëri ndër panairët më të mëdha në botë me pjesëmarrje nga pothuajse të gjitha vendet e botës, në pavione të ndara për industri të ndyrshme. Vizita në Dubai u realizua nga 27 deri 31 dhjetor e pjesë e delagacionit ishin përfaqësues të ndryshëm të institucioneve shtetërore si dhe **12** kompani të TIK-ut. **Përfaqësues:** Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive dhe Art Navakazi, Menaxher i Projekteve.



- Pjesë e takimit të përfaqësuesëve të kompanive në sektor me ministrin e financave z. Hekuran Murati lidhur me "**Pakon emergjente për rimëkëmbje - Aftësimi profesional në drejtime të TIK-ut**" të iniciuar nga ministria. Ky takim kishte qëllim konsultues lidhur me pakon e propozuar nga ministria dhe mënyrën më të mirë dhe efikase të shfrytëzimit të pakos. Takimi u mbajt më 26 korrik, por fatkeqësisht pas këtij takimi nuk gjetëm gjuhën e duhur të bashkpunimit dhe ministria vazhdoi me implementimin e pakos pa ndonjë input konkret nga sektori. **Përfaqësues:** Dominik Deda, Menaxher i Projekteve.
- Pjesë e misionit biznesor **Vienë** të organizuar nga projekti ACCESS dhe Austrian Development Agency (ADA). Vizita në Vienë u realizua më 5 deri 7 tetor e pjesë e misionit ishin përfaqësues të KIESA dhe 15 kompani të TIK-ut. **Përfaqësues:** Donjeta Sahatçiu, Kryetare e Bordit dhe Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive



OBJEKTIVI 1: TARGETET VS REALIZIMET

TARGET 1: *Komunikimi i rregullt dhe i vazhdueshëm me institucionet e ndryshme të Kosovës, donatorët dhe palët e tjera të interesit në sektorin e TIK-ut si dhe pjesëmarrja në konsultime dhe grupe punuese.*

Së paku **40 takime të realizuara** - Janë realizuar mbi **60+** takime me këtë qëllim.

Së paku **5 grupe punuese** - STIKK është përfshirë në **3** grupe punuese

TARGET 2: *Fuqizimi i raporteve me shoqata/oda biznesore në Kosovë dhe në vende të tjera.*

Së paku **4 takime të realizuara** - Janë realizuar mbi **10+** takime me shoqata dhe oda të ndryshme biznesore si në vend, poashtu edhe jashtë. Ndër to, vlen të thekësohet takimi me Presidentin e Federatës së Odave Biznesore të Izarelit dhe fillimi i bashkpunimit në projekte të Bashkimit European me Albanian Business Services Association (ABSA).

OBJEKTIVI 2: FUQIZIMI I RRJETËZIMIT DHE RITJJA E ANËTARËVE / PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE PËR ANËTARË

Ngjajshëm me vitin paraprak edhe gjatë 2021 shumë prej aktiviteteve të parapara u deshën të ndryshojnë format dhe të mbështeten në aspektet virtuale për shkak të pandemisë COVID-19, por kjo nuk kishte ndonjë efekt drastik në planet e **STIKK** drejt realizimit të objektivit 2. Në vazhdim mund t'i gjeni detajet e disa prej aktiviteteve kryesore të realizuara nën objektivin 2.

- **Leadership & Team Management Workshop - 25 Shkurt & 10 Mars** - Me përkrahjen e GIZ CETEP, në tremujorin e parë të vitit **STIKK** organizoi një puntori 2 ditore ku në fokus ishte menaxhmenti i kompanive të TIK-ut. Përgjatë punëtorisë ligjeruesja znj. Konstanze Bittmann diskutoi me pjesëmarrësit rreth stilit të tyre të menaxhimit të ekipeve, prezantoi metoda dhe këshilla për menaxhim më të mirë, etj. Puntoria është mbajtur virtualisht dhe kishte **19** pjesëmarrës.

- **AGILE IT Project Management Workshop - 16 & 18 Mars** - Edhe kësaj radhe, me përkrahjen e GIZ CETEP, **STIKK** organizoi edhe një punëtori tjetër, kësaj radhe duke u fokusuar në Junior dhe Mid-Level project managers në kompanitë anëtare. Ligjeruesja znj. Ines Harbauer përmes kësaj puntorie është munduar të shpalosë elementet kryesore të metodologjisë së punës AGILE dhe të demonstrojë se si këto elemente përdoren më së miri në ekip për t'i arritur rezultatet e dëshiruara. Punëtorja është mbajtur virtualisht dhe kishte **21** pjesëmarrës.
- **Femme-preneurs in ICT: Roundtable - 25 & 26 Shkurt** - Në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, **STIKK** organizoi një tryezë të rrumbullakët ku pjesëmarrëse ishin përfaqësuese dhe udhëheqëse të bizneseve nga Kosova dhe Amerika. Kjo tryezë shërbeu si një pikë takimi në mes të këtyre lidereve ku ato shkëmbyen eksperiencat, sfidat dhe sukseset gjatë rrugëtimit të tyre. Tryeza e rrumbullakët është mbajtur virtualisht dhe kishte **18** pjesëmarrëse.
- **Women in Tech Cluster - 1 Korrik** - Më 1 Korrik, **STIKK** organizoi një takim gjatë të cilit u finalizuan të gjitha detajet dhe edhe zyrtarisht u formua kllasteri i grave në TIK. Gjatë takimit u morën vendimet kyçe lidhur me modelin e veprimtarisë së kllasterit, u përzgjodh vizioni dhe misioni i kllasterit si dhe u përcaktuan disa prej objektivave fillestare të këtij kllasteri. Anëtarët themeluesë të kllasterit "**Women in Tech**" janë: Zana Tabaku (*Appdec*), Zana Budima (*ABS Software Development*), Arta Shehu Zaimi (*iCoders Academy*), Hana Qerimi (*Shkolla Digjitale & Starlabs*), Donjeta Sahatçiu dhe Rrita Rugova (*Rrota*), Melita Ymeraga (*Melita & Partners*), Ilirijana Ibraj (*LinkPlus IT*) dhe Vjollca Çavolli (*STIKK*).



Përveç punëtorive dhe webinarëve të lartpërmendura, viti 2021 u karakterizua me shumë evente të ndryshme B2B, kryesisht ndërkombëtare. Duke qenë bashkimplimentues i projektit *EEN Kosovo*, **STIKK** ishte co-organizator dhe pjesëmarrës në shumë evente të ndryshme duke ju ofruar kështu anëtarëve mundësi të shtuara për rrjetëzim me klientë e partner të rinj potencial. B2B eventet e organizuara gjatë vitit 2021 përfshijnë:

- **Qatar Matchmaking Event 2021 - 2 Mars** - 4 pjesëmarrës
- **EU Brokerage Event on Digital and Industrial Technologies, Mobility, OITB & M.ERA-NET - 7 Prill** - 1 pjesëmarrës
- **Prishtina Match4ICT Industry - 22 & 23 Prill** - 34 pjesëmarrës
- **Virtual Company Mission between Turkey, Kosovo and Albania - 5 Maj** - 24 pjesëmarrës
- **Italy meets digital Kosovo - 24 & 25 Qershor** - 37 pjesëmarrës
- **North Macedoni & Kosovo Company Mission - 19 Korrik** - 17 pjesëmarrës
- **B2B @ DigitalRailConvention 2021 - 8 Shtator** - 3 pjesëmarrës
- **ExpoCook 2021 - 28-30 Shtator** - 5 pjesëmarrës
- **MBM Tourism Prague 2021 - 1 Tetor** - 4 pjesëmarrës
- **B2B Networking at WEgate Annual Summit 2021 - 7 Tetor** - 8 pjesëmarrës
- **Kosovo & Slovenia meet in Ljubljana - 4 Tetor** - 6 pjesëmarrës
- **Takime me biznese nga Prizreni - 12 Maj** - 7 pjesëmarrës
- **Takime me bizneset nga Gjilani - 25 Prill** - 5 pjesëmarrës
- **Takime me bizneset nga Ferizaj - 10 Prill** - 4 pjesëmarrës
- **Expo Dubai 2020 - 27 Dhjetor** - 6 pjesëmarrës
- **ICT sector in Kosovo opportunities and incentives - 9 Nëntor** - 15 pjesëmarrës



Këtë vit, **STIKK** organizoi edicionin e 10 të festivalit të teknologjisë **KosICT** i cili u mbajt në ITP Prizren më 22 dhe 23 Tetor. Përgjatë dy ditëve të festivalit 54 folës. prej tyre 18 ndërkombëtarë e 36 vendore diskutuan për temat: eCommerce, Cyber Security, Artificial Intelligence, Big Data Anlysis, Internet of Things, Diaspora involvement, Women in Tech, etj. Ky edicion kishte **823** vizitorë në hapsirat e ITP Prizren, ndërsa **3032** vizitorë iu bashkangjitën përmes web platformës së festivalit.

Duke vazhduar traditën e përkrahjes dhe promovimit të StartUp-eve të reja me potencial edhe këtë vit "**Innovation Fair**" ishte pjesë e rëndësishme e festivalit ku u ekspozuan **14** StartUp's. Për dallim nga vitet paraprake, këtë edicion u organizua edhe panairi i kompanive dhe institucioneve akademike me fokus në shkathtësitë e TIK-ut, ku morën pjesë **5** kompani dhe **3** institucione akademike.

Promovimi i kompanive vendore është një target shumë i rëndësishëm për **STIKK** dhe në këtë frymë edhe ky edicion i **KosICT** u shoqërua me B2B evente të organizuara nën ombrellën e EEN dhe ku morën pjesë **35** biznese vendore e ndërkombëtare dhe u realizuan **34** takime one-on-one.

KosICT gjithashtu vazhdoi mbështetjen e zhvilluesëve të rinj përmes "**Future Developers Corner**" ku përgjatë 2 ditëve të festivalit **30** fëmijë nga *Shkolla Digjitale, jCoders Academy dhe laborator i robotikës në shkollën Finlandeze* demonstrian shkathtësitë e tyre duke zhvilluar projekte të ndryshme.

Krejt në fund, edicioni i 10-të u përmbyll me dy turnamente në eSports. Turnamenti i parë ishte garë bamirësie ku ekipet pjesëmarrëse të përbëra nga stafi i kompanive vendore të TIK-ut, garuan në lojën **CS:GO**. Fitues i kësaj gare ishte *Starlabs*. Turnamenti i dytë ishte tournament profesional me prize pool prej **3000 EUR**, ku pas kualifikimeve të hapura dhe fazës së grupe, ekipi nacional i Kosovës në **DOTA2** doli fitues i tournamentit pasi kanë mposhtur ekipin mysafir nga Shqipëria, BLINK, në finalen e madhe. Kjo ishte edhe paraqitja e fundit e ekipit të Kosovës para se të udhëtojnë në kampionatin botëror në Izrael nga ku u kthyen me medaljen e vendit të 3-të.



OBJEKTIVI 2: TARGETET VS REALIZIMET

TARGET 1: *Qarkullimi i informacionit për mundësi biznesore / aktivitete / ngjarje /lajme*

Gjatë 2021, STIKK ka dërguar më shumë se **89** lajme, njoftime, ftesa në aktivitete, etj. tek anëtarët.

TARGET 2: *Organizimi i trajnimeve të avancuara apo konsulencave profesionale për zhvillimin e brendshëm të kompanive anëtare përmes organizimit të: Webinareve, Workshopeve, Trajnimeve anëtarët për anëtarë etj.*

Së paku **2 trajnime të avancuara** të organizuara për anëtarët - Janë realizuar **2** trajnime të avancuara për anëtarët, njëra në "Leadership & Team Management" e tjetra "AGILE IT project management".

Së paku **1 konsulencë profesionale** të ofruar për anëtarët - Është realizuar **1** konsulencë profesionale lidhur me Corporate Governance në kompaninë anëtare Kutia.

Së paku **3 punëtori, webinar, trajnime** - Përgjatë vitit 2021, janë realizuar më shumë se **5** aktivitete të këtij lloji.

TARGET 3: *Promovim në media sociale, publikimi i një katalogu për shërbimet e ofruara, publikimi i lajmeve të kompanive anëtare, dokumentimi i vizitave tek kompanite me foto dhe storie etj.*

Përgjatë vitit 2021 janë vizituar **28** anëtarë të **STIKK** nga zyra ekzekutive si dhe janë shpërndarë shumë lajme, pozita të hapura, etj, të kompanive anëtare në faqet zyrtare të **STIKK** në rrjetet sociale.

TARGET 4: *Implementimi i IT Barometer 2021*

Për shkak të mungesës së fondeve për implementimin e proceseve të ndryshme gjatë përpilimit të IT Barometer, ky aktivitet është shtyrë për vitin 2022.

TARGET 5: *Organizimi dhe implementimi i B2B takimeve me sektorë të tjerë në Kosovë si dhe jashtë vendit*

Siç është evidentuar edhe më herët në këtë dokument, **STIKK** ka qenë mjaft aktiv në organizimin e B2B-ve të ndryshme dhe gjatë 2021 ka organizuar më shumë se **15** evente të tilla.

TARGET 6: *Organizimi i Festivalit Teknologjik KosICT (Edicioni i 10-të)*

Edhe pse me shumë të panjohura për shkak COVID-19 gjatë fazës së organizimit, edicioni i 10-të i KosICT-së u realizua me sukses dhe ishte ndër edicionet më të mëdha të festivalit.

OBJEKTIVI 3: KRIJIMI I KUSHTEVE PËR VEPRIMTARI TË QËNDRUESHME TË STIKK-UT

Objektivi i 3-të i vitit 2021 u fokusua në krijimin/sigurimin e fondeve për veprimtari të qëndrueshme të **STIKK**-ut e për ta arritur këtë qëllim u punua në disa drejtime të ndryshme. Fillimisht, ekipa e **STIKK** ka mbajtur më shumë se **35** takime të ndryshme me donatorë dhe pale të tjera të interesit në përpjekje të sigurimit të mbështetjes nga këto palë.

Ekipa e **STIKK** u takua edhe me shumë kompani të TIK-ut, jo anëtarë në shoqatën tonë, ku u shpalosën vlerat e të qenit anëtar i shoqatës, benefitet e ndryshme, etj. Nga këto takime u siguruan **6** anëtarësi të reja.

Gjatë vitit 2021, ekipa e **STIKK** ka draftuar **7** projekt-propozime të reja, **5** për thirrje të Komisionit European, **1** për thirrje të Agjensionit për Barazi Gjinore nën zyrën e Kryeministrit dhe **1** të drejtuar tek Western Balkans Fund. Nga këto **7** propozime, **5** prej tyre janë realizuar në partneritet me organizata të ndryshme ndërkombëtare e vendore ndërsa **2** të tjera vetëm nga **STIKK**. Prej 6 projekt propozimeve të draftuara, **2** prej tyre janë aprovuar. Projekti **SheStore** nën mbështetjen e ABCJ-së u përmbyll në Shtator, ndërsa projekti Star-Up! i mbështetur nga Komisioni European do të fillojë implementimin gjatë vitit 2022. Projekti propozimi për vazhdimin e programit EEN edhe për 3 vite të tjera për momentin është në fazën e evaluimit dhe vendimi pritet të komunikohet në javët e para të muajit Shkurt.

Në fund, në mënyrë që ekipa e **STIKK** t'iu ofroj shërbime sa më kualitative anëtarëve ata kanë ndjekur disa trajnime me qëllim të ngritjes së kapaciteteve. Këto trajnime përshijnë:

- **Taxonomy, Corporate Sustainability Reporting Directive (CSRD) and sustainable finance** - Enterprise Europe Network - **13 Tetor**
- **Cybersecurity and online presence** - Enterprise Europe Network - **14 Tetor**
- **AGILE IT project management** - GIZ CETEP - **16 & 18 Mars**

OBJEKTIVI 3: TARGETET VS REALIZIMET

TARGETI: *Aktivitete për rritjen e fondeve për funksionim të shoqates*

Së paku **20 takime të realizuara me donatorë** të mundshëm (me ndihmën e anëtarëve) - Përgjatë vitit 2021, ekipi i **STIKK** ka realizuar më shumë se 35 takime me palë të ndryshme me qëllim të rritjes së fondeve përmes projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme në benefit të anëtarëve.

TARGET 2: *Aktivitete për rritjen e numrit të anëtarëve të shoqatës*

Siç është evidentuar edhe paraprakisht, ekipi në **STIKK** ka realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve me kompani anëtare e jo-anëtare, fillimisht duke i vizituar të gjithë anëtarët e ri nga viti paraprak e gjithashtu duke u takuar me kompani jo-anëtare për t'i njoftuar rreth veprimtarisë dhe vlerave të **STIKK** që kanë rezultuar në **9** anëtarë të ri në shoqatë.

TARGET 3: *Përpilimi i projekt propozimeve të reja*

Së paku **3 projekt propozime** të aprovuara nga donatorët - Janë draftuar **7** projekt propozime të reja gjatë vitit, **2** prej tyre të aprovuara dhe **1** në proces të evaluimit.



TARGET 4: *Ngritja e kapaciteteve të stafit të STIKK*

Së paku **2 trajnime** të avancuara për stafin e **STIKK** - Ekipa e **STIKK** gjatë vitit 2021 ka marrë pjesë në 3 trajnime të tilla.


TË HYRAT DHE SHPENZIMET E STIKK

Përgjatë vitit 2021, ekipi i **STIKK** ishte mjaft aktiv me aktivitete, takime e iniciativa të ndryshe përmes të cilave u munduam t'i përmbahemi dhe përmbushim objektivat e përcaktuara. Në vazhdim mund t'i gjeni detajet e ndara në objektivat përkatës.

TË HYRAT



SHPENZIMET



KUVENDI I XIII-TË I STIKK

Përshkak të gjendjes emergjente si rezultat i pandemisë COVID-10 dhe masave në efekt të cilat parandalonin grumbullimin në grupe të mëdha, më 4 Mars 2021 në mënyrë hibride u organizua takimi i trembëdhjetë (XIII) i Kuvendit të anëtarëve të **STIKK** në tentativën e dytë për t'u takuar, pasi që në tentimin e parë nuk kishte të pranishëm të mjaftueshëm që të përmbushet kuorumi për vendimmarje.

Gjatë takimit, që për shkak të natyrës së organizimit hibrid ishte më i shkurtër se zakonisht, para anëtarëve të pranishëm u prezantuan rezultatet dhe të arriturat e **STIKK** gjatë vitit 2020 si dhe u shpalos dhe u hap për diskutim plani i punës për vitin 2021.

Në fund të rendit të ditës ishte edhe përzgjedhja e anëtarëve të bordit pasi 4 prej anëtarëve të deriatëhershëm iu skadoi mandati 1 vjeçar dhe pas votimit u konfirmuan konfirmuan: z. Astrit Leti (*Cactus*); z. Astrit Desku (*Komtel Project Engineering*) dhe z. Valon Canhasi (*Hallakate*), si dhe anëtar i ri i bordit u përzgjodh z. Muharrem Shefiku (*Polymath Labs*).



ADDRESS:

Str. Rexhep Mala 28A, Prishtina,
10000, Kosovo



WEBSITE:

www.stikk.org



PHONE:

+383 (0) 38 77 11 80
Ext. 501



EMAIL

infoi@stikk.org



STIKK
KOSOVO ICT ASSOCIATION